



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Manastirliu në OKB: Fuqizimi i grave dhe vajzave me fokus gratë në zonat rurale

2018-03-13 11:21:00



Ministrja në sesionin e 62 të Komisionit për Statusin e Gruas: Bashkojmë forcat për Barazinë Gjinore. Forcojmë masat kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave

New York, 13 Mars - Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Ogerta Manastirliu po merr pjesë në sesionin e 62 të Komisionit për Statusin e Gruas, që po mbahet në Organizatwn e Kombeve të Bashkuara në New York. Gjatë tryezës ministeriale të zhvilluar sot për Praktika dhe shembuj pozitivë për fuqizimin e grave dhe vajzave rurale, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fjalën e saj evidentoi sfidat me të cilat përballet gruaja shqiptare në zonat rurale si: lufta kundër stereotipeve gjinore, pabarazia gjinore, parandalimi i të gjitha formave të dhunës ndaj grave, aksesit në shërbimet shëndetësore dhe sociale, etj. Në këtë kontekst, znj. Manastirliu theksoi fokusin që Qeveria Shqiptare i ka kushtuar fuqizimit ekonomik dhe social të grave rurale nëpërmjet skemave të punësimit dhe gjithëpërfshirjes së grave.

“Adresimi i pengesave me të cilat përballen gratë dhe vajzat rurale, është një nga prioritetet e qeverisë shqiptare, si pjesë integrale e angazhimit të marrë për më shumë barazi gjinore dhe përfshirje sociale. Puna jonë është kryesisht e fokusuar në parandalimin e dhunës me bazë gjinore në zonat urbane dhe rurale; rritja e aksesit të grave dhe vajzave në sistemin gjyqësor, përmirësimi i jetës në zonat rurale, falë reduktimit të punës së papaguar në sektorin bujqësor, duke bërë të mundur që më shumë gra dhe vajza në zonat rurale të përfitojnë nga skemat e subvencionit, si dhe të garantohet e drejta mbi pronën dhe tokën bujqësore”, tha Manastirliu.

Ministrja gjatë fjalës së saj u ndal në disa nga praktikrat dhe shembujt pozitiv të ndërmarrë nga qeveria shqiptare për fuqizimin e gruas rurale:

“Kemi ndërmarrë hapa të rëndësishëm në kuadër të harmonizimit të legjislacionit Shqiptar me standardet

ndërkombëtare. Amendimet ligjore të ligjit mbi masat e dhunës në familje, ligjit për ndihmën juridike, kanë pasur një impakt të drejtpërdrejtë në reduktimin dhe ofrimin e zgjidhjeve më të mira për çështje kyçe me të cilat përballet shoqëria shqiptare, si dhuna kundër grave dhe dhuna në familje. Të dhënat më të fundit tregojnë se gratë dhe vajzat në zonat rurale dhe urbane, sot ndihen më besimplotë për të raportuar pranë autoriteteve, rastet e dhunës dhe abuzimit. Në vitin 2017 kemi pasur 10% më shumë raportime të dhunës në familje pranë organit të policisë krahasuar me një vit më parë”, u shpreh Manastirliu.

Ofrimi i aksesit për gratë e mbijetuara të dhunës në sistemin gjyqësor është një prioritet për qeverinë Shqiptare. Megjithatë, Ministria theksoi në fjalën e saj të parë në sesionin e 62 të Komisionit për Statusin e Gruas, se do të duhet të intesifikojmë angazhimin tonë për të siguruar që gratë trajtohen të barabarta në sistemin tonë gjyqësor, dhe mbi të gjitha t’u ofrohet e gjithë mbështetja e duhur ligjore.

“Parandalimi i dhunës është një nga qëllimet kryesore të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Planit të saj të Veprimit 2016 – 2020, që synon në rritjen me 30% të numrit të qytetarëve, që mbështesin strategjinë dhe vizionin e Zero Tolerancë nga dhunës kundër grave”, tha Manastirliu.